

VENDIM
Nr. 905, datë 17.12.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“9. Përfshihet për vitin 2014, fondi i veçantë i njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve, me përjashtim të shpërblimit për kategoritë e mëposhtme:

- Mësuesve me rezultate të mira në procesin e mësimdhënies për vitin 2014, në masën deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë;

- Trupës më të mirë policore për vitin 2014, në masën deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

- Punonjësve të 3 shërbimeve spitalore, të renditura si shërbimi më i mirë spitalor në vend për vitin 2014, në masën deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

- Punonjësve të Parkut Kombëtar të Divjakës, në masën deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama